

Një hap më tej drejt zgjidhjes së duhur



Nëse keni një ndërmarrje mikro, të vogël, të mesme
apo jeni fermerë të regjistruar dhe jeni prekur
nga pasojat e pandemisë, vizitoni
www.cosolve19.al



CoSolve-19

Këshillim. Përshtatje. Grante.



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH





Si funksionon CoSolve-19?

Hapi 1 – do të rezultojë në planin individual të ndërhyrjes për çdo biznes.

Hapi 2 – do të zhvillohen trajnime specifike për ndryshimin/përshtatjen e planit individual të biznesit sipas planit të veprimit të hartuar në hapin e parë.

Hapi 3 – ka të bëjë me vijimin e këshillimit/trajnimin në fazën e zbatimit të planit të ri në biznesin përkatës.

Të tre hapat do të zbatohen brenda një periudhe maksimale prej 6 muajsh në varësi të nevojave, disponueshmërisë dhe vendndodhjes së aplikantit.

Secili hap mund të zgjasë deri në një ditë pune të ndarë në disa seanca trainimi. Aplikantëve do tu ofrohen edhe aktivitete/trajnime të tjera në grup, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, apo mundësi bashkëpunimi mes tyre. Pjesëmarrësit në shërbimet këshillimore të CoSolve-19 do të zhvillojnë një plan konkret ndërhyrjeje për biznesin e tyre dhe do të kenë mundësi që të zbatojnë ndryshime pozitive në bizneset/fermat e tyre.

Sektorët që mund të marrin pjesë në thirrje



Turizëm

Thirrja është e hapur për bizneset e akomodimit të regjistruara mikro, të vogla, të mesme operatorë turistikë të regjistruar si edhe restorante në zonat rurale që ofrojnë aktivitete turistike.

- ▶ NMVM akomodimi (hotele, agroturizëm, bujtina, kampingje)
- ▶ Operatorë turistikë të regjistruar dhe guida turistike
- ▶ Struktura shërbimi (bare & restorante në zonat rurale që ofrojnë aktivitete turistike)

Bujqësi

Thirrja është e hapur si për fermerë individualë ashtu edhe për persona fizikë dhe juridikë që zotërojnë, apo përfaqësojnë NMVM që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin, grumbullimin, përpunimin, apo marketimin e produkteve bujqësore.

- ▶ Fermerë individualë (me NIPT aktiv fermeri)
- ▶ Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
- ▶ NMVM-të që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin, grumbullimin, përpunimin, marketimin dhe shitjen e produkteve bujqësore.



Sektorë të tjerë

Thirrja është e hapur për NMVM-të:

- ▶ Prodhues të tekstileve dhe veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, bizneseve të artizanatit etj.
- ▶ Biznese të tjera që janë dëmtuar si pasojë e Covid-19.

Për të tre sektorët e CoSolve-19, do të ketë një dritare të veçantë këshillimi për zgjidhje inovative dhe digjitale të funksionimit të bizneseve.

Në këtë thirrje, NMVM-të kërkohet të dorëzojnë aplikime ku përcaktohet një nevojë e qartë biznesi që u ka dalë gjatë, apo si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19 në të paktën një prej fushave të ushtrimit të aktivitetit të biznesit:

- ▶ Zhvillim produkti
- ▶ Burime njerëzore
- ▶ Marketim dhe/ose mekanizëm shitjesh
- ▶ Tregje të reja
- ▶ Inovacion dhe teknologji
- ▶ Menaxhim cilësie, përfshirë standardet dhe certifikimin
- ▶ Menaxhim financiar

Qeveria gjermane në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, kanë krijuar instrumentin këshillimor, **CoSolve-19**.

Ky instrument synon masa mbështetëse për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorë të ndryshëm, si dhe fermerë të regjistruar. Këto masa do ndihmojnë ndërmarrjet dhe fermerët të përshtaten, të kenë një zhvillim më të qëndrueshëm dhe të tejkalojnë më lehtë krizën e shkaktuar nga COVID-19 përmes trajnimeve, njohjes me zgjidhje të reja digjitale për bizneset dhe mundësisë për tu bërë pjesë e skemës së granteve, pas përfundimit të trajnimeve.

Rregullat e thirrjes për propozime

- ▶ **Madhësia:** Xhiroja maksimale e NMVM-së sipas ligjit shqiptar deri në 14.000.000 Lek në vit.
- ▶ **Pronësia:** 100% biznese me pronësi private, në zotërim të shtetasve shqiptarë.
- ▶ Bizneset duhet të jenë të regjistruara si ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme, apo të kenë Nipt aktiv fermeri.
- ▶ **Maturimi:** Biznesi duhet të ketë ushtrim zyrtar aktiviteti minimumi 6 muaj para fillimit të pandemisë COVID-19 (biznesi është regjistruar para 1 Tetor 2019).



CoSolve-19

Këshillim. Përshtatje. Grante.

Na kontaktoni:

Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
E: cosolve@giz.de

Na vizitoni në webfaqen tonë:
www.cosolve19.al